PROJEKTLIGJ “PËR SHËRBIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Prezantim

PËRMBAJTJA DHE QËLLIMI I PROJEKT-AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

- Ligji ka si qëllim sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore përmes formave institucionale dhe jo-institucionale të përkujdesit, në mënyrë që të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përfshirjen shoqërore të personave të pafavorizuar në shoqëri.
- Në të njejtën linjë me reformën e decentralizimit ligji synon krijimin dhe administrimin e shërbimeve shoqërore komunitare dhe ditore, thuajse tërësisht nga njësitë e qeverisjes vendore.
- Objektivi i ligjit është rregullimi dhe ofrimi i shërbimeve sociale në atë mënyrë që të mundësojnë zbulimin në kohë të nevojave të përfituesve dhe ofrimin e atyre shërbimeve që ndihmojnë në parandalimin ndodhjen dhe/ose zhvillimit e kushteve apo situatave kërcënuese që prekin grupet në nevojë
- Synon identifikimin dhe përcaktimin e të gjithë target grupeve në nevojë dhe parashikimin e shërbimeve për ta.
- Përcakton parimet, gamën e përfitimeve dhe lehtësirave, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar nga skema e shërbimeve shoqërore si edhe procedurat e kërkimit dhe përfitimit të të drejtave të shërbimeve shoqërore.
- Ligji përcakton rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike të ngarkuara me zbatimin e tij.

RISITË E PROJEKT AKTIT

- Ky projekt ligj vjen si domosdoshmëri e nevojave të kohës për të patur një sistem të mirëorganizuar dhe funksional të ofrimit dhe përfitimit të shërbimeve shoqërore.
- Në ndryshim nga e kaluara ligji jep një pasqyrë të qartë të llojit, përkufizimeve dhe listës së shërbimeve shoqërore që do të ofrohen nga operatorë publikë, jo publike (OJF) dhe privatë
- Ligji ndan qartësisht kategoritë e përfituesve sipas nevojës dhe llojit të shërbimit. Të drejtën për të përdorur shërbimet shoqërore e kanë individë ose familje të cilët nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t'i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera.
- Ngre mekanizmat e duhura të ofrimit të shërbimeve por edhe të kontrollit nëpërmjet një strukture të re të veçantë si Inspektorati i Shërbimeve Shoqërore si një trup i vecante në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale. (Ne cdo rast eshte parashikuar alternativa si pjese e Inspektoriatit te Punes por me kritere te tjera)
- Përcakton sanksionet e aplikueshme për çdo shkelje, përdorues apo institucion, në ndryshim nga kuadri ligjor aktual që mbetet me shumë ambiguitet dhe gjithsesi i zbatueshëm më shumë vështirësi.
- Ligji rregullon njëherë e mirë ofrimin e shërbimeve shoqërore nëpërmjet prokurimit të tyre duke bërë ndërhyrjet adekuate ligjore jo vetëm në këtë ligj por edhe në ligjin e prokurimit publik pa prekur aspak strukturën e këtij të fundit.
- Detajon dhe klasifikon të gjitha rolet dhe funksionet që do të kenë institucionet në nivel qendor dhe vendor në ofrimin e shërbimeve shoqërore. Një risi absolute është ngritja e sektorëve të vlerësimit të nevojave dhe referimit (SVNR) në çdo komunitet.
- Ligji përcakton dhe ngritjen e fondit social pranë çdo bashkie.

FUSHA E ZBATIMIT

- Ky ligj përcakton gamën e përfitimeve dhe lehtësirave, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar shërbime shoqërore si edhe procedurat e kërkimit dhe përfitimit të të drejtave të shërbimeve shoqërore.
- Ligji përcakton rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike të ngarkuara me zbatimin e tij

PËRKUFIZIMET KRYESORE

- “Shërbime shoqërore” – janë një sistem i integruar dhe organizuar përfitimesh dhe lehtësirash të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve shtetërore ose private me qëllim përmirësimin e kushteve të personave të pafavorizuar.
- “Shërbime shtëpiake – janë shërbimet që ofrohen nga punonjësit social në kushtet e shtëpisë, për ato kategori në nevojë që e kanë të pamundur ta marrin shërbimin në komunitet apo qendër rezidenciale.
- “Shërbimet e specializuara” janë shërbimet e ofruara në nivel rajonal për fëmijët me çrregullime të spektrit autik dhe femrat e abuzuara, dhunuara apo trafikuara.
- “Përdorues i shërbimeve shoqërore” – është subjekti, individ ose familje, që përmbush kushtet për të përfituar të drejtat nga shërbimi shoqëror.
- “Fëmijë” - do të konsiderohet çdo individ deri në moshën 18 vjeç, përfshirë fëmijët pa prindër apo pa përkujdesje adekuate prindërore, fëmijët viktimë e dhunës në familjes, apo çdo lloj tjetër dhune, fëmijët viktima të trafikimit, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në rrezik, fëmijët në nevojë të mbrojtjes së veçantë, fëmijët pa kujdestarë, fëmijët që gjenden jashtë vendbanimit të tyre pa pëlqimin e prindërve apo kujdestarit të tyre;
- “Person me Aftësi të Kufizuar”- Individët, fëmijë ose të rritur, me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.
- “Punonjësi social” është i punësuari në shërbim të kategorive përfituese të shërbimeve shoqërore si pjesë e sistemit publik dhe jo publik të ofrimit të shërbimeve shoqërore.

PARIMET KRYESORE

- Parimi i drejtësisë sociale: Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat të cilët ka detyrim ligjor ti mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen per veten e tyre.
- Parimi i subsidiaritetit: Shërbimet shoqërore ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.
- Parimi i mbështetjes shoqërore: Subjektet të cilët përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet shoqërore, kanë të drejtën e përfitimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj, dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë dhe pamundësisë.
- Parimi i deinstitucionalizimit: Shërbimet shoqërore sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose kumunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shpirtërore të njerëzve në vështirësi.

KATEGORITË E PËRDORUESVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Përdoruesit e shërbimeve shoqërore përfshijnë këto grupe shoqërore:

- Fëmijët, kur nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dhe janë në pamundësi apo vështirësi për shkak se janë pa prindër, pa kujdestarë, jashtë familjes ose larg kujdesit prindëror apo kujdestarisë, viktimat apo viktimat e mundshme të abuzimit, trafikimit apo dhunës në familje;
- Personat me aftësi të kufizuara;
- Të rriturit, përfshirë gratë dhe vajzat, me probleme sociale, viktima ose viktima të mundshme të abuzimit, trafikimit, dhunës në familje, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;
- Femrat shtatzënë apo prindi i vetëm i një fëmije nën moshën një vjeçare;;
- Të moshuarit, ku përfshihen personat mbi moshën e aftësisë për të punuar;
- Individi i cili nuk përfshihet në kategoritë e përdoruesve të shërbimeve shoqërore, gjithashtu ka të drejtë kundrejt tarifave përkatëse të kërkojë sistemim të përkohshëm në institucionet e ofrimit të shërbimit, qofshin këto dhe rezidenciale apo komunitare sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj, deri në mbarimin e rrethanave të veçanta për të cilat ka kërkuar shërbimin.

LLOJET E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

- Shërbimet para shoqërore (Këshillimi dhe informimi; Trajtimi në shtëpi; Mbështetja psiko-sociale ; Ndërhyrja e hershme dhe vlerësim i nevojave)
- Shërbimet në qendrat komunitare përfshirë qendrat e zhvillimit;
- Shërbimet në qendrat rezidenciale/ditore (akomodimi afatgjatë/afatshkurter; akomodimi i organizuar; strehëzat; strehezat e perkohshme);
- Shërbimet shoqërore në situatë emergjence.
- Shërbimet shoqërore janë shërbime rezidenciale kur është e pashmangshme dhe e papërshtatshme ofrimi i tyre në familje apo komunitet.
- Sherbimet alternative- si sherbimi I kujdestarise perkohshme
- Transformimi I institucioneve – plani deinstitucionalizimit

SUBJEKTET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

- Shërbimet shoqërore ofrohen nga personat juridikë publikë apo jo publikë, të licencuar për këtë qëllim.
- Shërbimet shoqërore të financuara privatisht zbatohen nga subjekte jo publike por sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.
- Ofrimi i shërbimeve shoqërore, në çdo rast bëhet në përputhje me standardet e hartuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

PËRGJEGJËSIA PËR ZBATIMIN E SISTEMIT TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

- Zbatimi i sistemit të shërbimeve shoqërore që financohen nga buxheti i shtetit dhe nga buxhetet e njësive të qeverisjes vendore, në përputhje me kërkesat dhe mënyrën e përcaktuar në ligj, është përgjegjësi e organeve publike
- Institucionet përgjegjëse për zbatimin e sistemit të shërbimeve shoqërore janë:
- a. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe institucionet e saj të varësisë (SHSSH, Inspektorati i Shërbimeve Shoqërore);
- b. Këshilli i Qarkut
- c. Bashkia
- Ligji percakton në mënyrë të detajuar rolet, përgjegjësitë dhe funksionet e secilit prej institucioneve të mësipërme. Gjithashtu përcaktohen roli i punonjësit social të NJQV-së

PROKURIMI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE

- Veprimtaritë e përkujdesit shoqëror të ofruara nga subjektet jo publike janë objekt liçensimi.
- Shërbimet shoqërore prokurohen nga Bashkitë tek ofruesit privatë të tyre, me procedurë të veçantë negocimi, si përjashtim i veçantë nga procedurat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.
- Bashkitë lidhin kontratë me subjektet privatë fitues, për shërbimet që ato ofrojnë në juridiksionin e territorit të tyre.
- Procedura e negocimit përfshin negocimin e llojit, sasisë, cilësisë, standarteve dhe çmimit të shërbimeve shoqërore.
- Në çdo rast, ofruesit e shërbimeve duhet të ofrojnë minimumin e shërbimeve dhe cilësisë së tyre, për fushën respektive të veprimtarisë së ushtruar.
- Vlerësimi i ofertës fituese bazohet në një raport të drejtë cilësi/çmim duke konsideruar veçanërisht cilësinë dhe standardet e shërbimeve.

MEKANIZMAT E FINANCIMIT

- Njësia e qeverisjes vendore planifikon, ndërton, administron dhe mirëmban rregullisht shërbimet shoqërore të ofruara brenda territorit të saj nëpërmjet buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore.
- Ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe Ministri i Financave udhëzojnë njësitë e qeverisjes vendore në lidhje me mekanizmat e përshtatshëm financiarë dhe kriteret për vendosjen e tarifave për përballimin e kostove të ofrimit të shërbimeve shoqërore.
- Shërbimet shoqërore publike të ofruara në nivel qendror financohen nga buxheti i shtetit nëpërmjet ministrit përgjegjëse për çështjet sociale.
- Tarifat e shërbimeve sociale publike të financuara nga buxheti i shtetit caktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjëse për çështjet sociale dhe ministrit të financave.

BURIMET E FINANCIMIT

- fondet e deleguara nga Buxheti i Shtetit;
- fondet e caktuara nga Buxhetet vendore;
- të ardhurat e caktuara nga pasuritë dhe veprimtari të tjera të bashkisë;
- kontributet e përfituesve të shërbimeve shoqërore;
- dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë apo individë të tjerë

FONDI SOCIAL

- Ministria përgjegjëse për çështjet sociale krijon dhe administron Fondin Social nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore me qëllim përmirësimin e standarteve dhe kapaciteteve administruese të shërbimeve shoqërore ekzistuese, krijimin e shërbimeve të reja, si edhe për zhvillimin e politikave sociale në nivel vendor apo kombëtar.
- Fondi Social përbëhet nga të ardhura vjetore nga buxheti i shtetit si dhe:

a. financime jashtë buxhetore nga organizata vendase apo të huaja, ose persona të tjerë;

b. të ardhurat nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme shoqërore;

c. të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Procedurat e krijimit dhe funksionimit të Fondit Social rregullohen dhe miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

SANKSIONET

- Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kur nuk përbëjnë vepër penale:
- ✓ përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, sipas ligjit për kundërvajtjet administrative;
- ✓ shkelje disiplinore.
- Në rast të evidentimit shkeljeve disiplinore nga ana e punonjësve të institucioneve publike zbatuese të këtij ligji, nis procedimi disiplinor dhe merren masa në përputhje me rregullat e Kodit të Punës ose ligjit të nëpunësit civil, sipas përkatësisë së punonjësit.
- Inspektorati i shërbimeve shoqërore për zbatimin e legjislacionit për shërbimet shoqërore, për shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, konstaton kundërvajtjen administrative dhe vendos aplikimin e sanksioneve përkatëse.

FALEMINDERIT